



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 42 dt.08.05.1995

MBI
PROBLEMET E KRIJUARA NE NDERMARRJEN "DRINI"

Këshillit Bashkiak i Qytetit të Tiranës, i mbledhur në dt.08.05.1995, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Seksioni i Tregtisë dhe Industrisë Ushqimore dhe mendimin e Komisionit Ekonomik dhe Buxhetit "Mbi problemet e krijuara në Ndërmarrjen "Drini", në zbatim të kompetencave që i jep ligji "Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal" Nr.7572, dt.10.06.1992, pika.10 dhe ligji "Për ndërmarrjet shtetërore" Nr.7582, dt.13.07.1992, neni.19, pika.5

VENDOSI

1. Ndërmarrja "Drini" të jetë pronë e Bashkisë së qytetit të Tiranës.
2. Komisioni Ekonomik dhe i Buxhetit, Seksioni i Tregtisë dhe Industrisë Ushqimore, në bashkëpunim me Drejtorinë e Ndërmarrjes të rishikojnë procedurën e krijimit të Ndërmarrjes së Përbashkët me grupin italian dhe problemet e tjera, dhe t'i paraqesin një material të veçantë Këshillit Bashkiak.

KRYETARI

BESNIK PETRELA